**Vendim nr. 300, datë 28.09.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Fiona Papajorgji, | Kryetare |
| Marjana Semini, | Anëtare |
| Asim Vokshi, | Anëtar |

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (O) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **ORTENCA (TUÇI) DASHI, JULIAN DASHI**, përfaqësuar nga avokati Zhuljen Ristani, me prokurë.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2919, datë 10.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1070, datë 09.05.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-3903, datë 04.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 54, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja ka qenë në marrëdhënie pune pranë një banke të nivelit të dytë në pozicionin e drejtoreshës së sektorit të vlerësimit të riskut të kredisë. Gjatë vitit 2012 ajo ka qenë në pritje të një fëmije dhe ka rezultuar se ka punuar pa ndërprerje duke mos përfituar lejen e barrëlindjes 35 ditë përpara datës së planifikuar për ardhjen në jetë të foshnjës.

2. Në datën 31.12.2012 kërkuesja i është nënshtruar lindjes së parakohshme. Fetusi ka rezultuar pa jetë, ndërsa shkaku i vdekjes është përcaktuar infarkti central. Më pas, ajo dhe bashkëshorti i saj, gjithashtu kërkues, i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e punëdhënësit për t'iu shpërblyer dëmin e plotë pasuror dhe jopasuror për shkak të vdekjes së foshnjës së tyre. Pretendimi i tyre ishte se qëndrimi në punë gjatë periudhës së ndalesës ligjore ka ndikuar negativisht në shëndetin e nënës dhe të fetusit, duke sjellë si pasojë vdekjen e foshnjës gjatë një procesi të parakohshëm lindjeje dhe se është punëdhënësi ai që ka detyrimin për të konstatuar këtë fazë shtatzënie, për të mos lejuar punëmarrësin të vijojë procesin e punës.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 29, datë 10.04.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi ka çmuar se pala paditëse nuk arriti të vërtetojë se dëmi i pretenduar, si rrjedhojë e vdekjes së fetusit, ishte pasojë e drejtpërdrejtë, e menjëhershme dhe determinante e veprimeve me faj të palës së paditur, të ndërmarra gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, në ushtrimin e të drejtave dhe në përmbushjen e detyrave që burojnë nga legjislacioni i punës. Në këtë përfundim ajo gjykatë ka arritur pasi ka analizuar nëse përmbushen kushtet ligjore për vënien nën përgjegjësi civile për shkaktim dëmi të palës së paditur, punëdhënësit.

4. Ajo gjykatë ka vlerësuar se në rastin konkret nuk provohet *veprimi i paligjshëm* i palës së paditur në shkaktimin e dëmit. Për këtë, ajo ka arsyetuar se detyrimi për të mos punuar gjatë periudhës së ndalimit, i garantuar nga neni 104 i Kodit të Punës, i kundërdrejtohet të dyja subjekteve të lidhura në një marrëdhënie punësimi, megjithatë konstatimi i fillimit të periudhës së ndalimit të punës për gruan shtatzënë nuk është përgjegjësi e punëdhënësit, pasi ndonëse shtatzënia është një gjendje fizike drejtpërdrejt e perceptueshme në dukje nga të tretët, evidentimi i fillesës së periudhës së paralindjes përbën një fakt gjinekologjik, i përcaktueshëm vetëm nga personeli mjekësor dhe i materializuar në raportin e paralindjes të lëshuar prej tyre, të cilin punëmarrësi detyrohet t'ia paraqesë punëdhënësit si indicie për shkëputjen e përkohshme të marrëdhënies së punësimit. Në ndihmesë të këtij argumenti, gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se ekziston ndalimi ligjor i punëdhënësit për kërkimin dhe mbledhjen e provave me karakter personal për punëmarrësin. Në vlerësimin e asaj gjykate, është detyrë ekskluzive e nënës/punëmarrëse që në kuadër të përkujdesjes që duhet të tregojë për mbarëvajtjen e zhvillimit të fetusit, krahas

kontrolleve periodike gjatë ecurisë së shtatzënisë, të sigurojë shkëputjen nga puna gjatë periudhës së ndalimit të punësimit, duke informuar punëdhënësin përmes paraqitjes së raportit të barrëlindjes. Nga hetimi gjyqësor, sipas saj, nuk ka rezultuar e provuar që kërkuesja të ketë informuar punëdhënësin për moshën e shtatzënisë, kohën e planifikuar për ardhjen në jetë të foshnjës dhe, për pasojë, fillimin e periudhës së lejes së lindjes, ndonëse gëzonte të gjitha mundësitë dhe mjetet e nevojshme për t'i bërë me dije punëdhënësit nevojën e shkëputjes së përkohshme të marrëdhënies së punës për shkak të fillimit të lejes së paralindjes. Sipas asaj gjykate, në asnjë nga provat që i janë nënshtruar hetimit gjyqësor nuk rezulton që kërkuesja t'i ketë kërkuar punëdhënësit fillimin e lejes së lindjes dhe kjo kërkesë të jetë refuzuar prej tij. Në të kundërtën, arsyeton ajo, rezulton se më 24.12.2012, pra vetëm 6 ditë përpara lindjes së foshnjës, kërkuesja i ka kërkuar punëdhënësit përfitimin e lejes së prapambetur vjetore, referuar kërkesës së paraqitur sipas formularit të lejes të administruar në cilësinë e provës në gjykim. Ndaj saj rëndonte detyrimi i paraqitjes pranë punëdhënësit të raportit mjekësor ku të përcaktohej periudha 35-ditore e paralindjes gjatë së cilës ndalohet puna e gruas shtatzënë. Ajo nuk ka marrë pranë personelit mjekësor që ka ndjekur shtatzëninë raportin e paralindjes dhe, për pasojë, nuk ia ka paraqitur as punëdhënësit. Sipas vërtetimit, datë 22.05.2013 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, kërkuesja nuk është paguar për raportin e paralindjes, pasi ky dokument mjekësor nuk është paraqitur prej saj. Në këto kushte, gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzionin se nuk rezulton që punëdhënësi të ketë qenë në dijeni të faktit se kërkuesja po vijonte punën gjatë kohës së ndalimit të punësimit dhe të ketë lejuar në kundërshtim me ligjin vazhdimësinë e marrëdhënies së punës, duke i refuzuar punëmarrëses dhënien e lejes së paralindjes. Në vlerësimin e asaj gjykate, kërkuesja, në cilësinë e paditëses, nuk mund t'i kundërdrejtojë punëdhënësit përgjegjësinë në shkaktimin e dëmit, në kushtet e mosveprimit të saj në kundërshtim me ligjin për informimin e punëdhënësit për statusin e shtatzënisë.

5. Në lidhje me elementin e *lidhjes shkakësore* midis sjelljes së paligjshme, fajit dhe pasojës së ardhur, gjykata e shkallës së parë ka lejuar kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor për të përcaktuar shkakun përcaktues dhe të drejtpërdrejtë të vdekjes së fetusit dhe nëse puna e ushtruar nga kërkuesja gjatë periudhës së ndalimit ligjor, duke marrë në konsideratë natyrën dhe kushtet e saj, përbën shkakun që ka sjellë si pasojë vdekjen e fetusit. Ekspertimi konkludoi se për shkak të mungesës së ekzaminimeve histopatologjike të fetusit, placentës ose kordonit umbilikal nuk mund të përcaktohet me saktësi shkencore shkaku i vdekjes, por bazuar në të dhënat e dokumentacionit të dosjes gjyqësore vdekja ka ardhur për shkak të ndërprerjes së furnizimit me gjak dhe oksigjen me pasojë infarktit central të placentës së nënës. Në mungesë të sëmundjeve të fetusit ose të nënës

deri në javën e 36-të ka rezultuar nga ekspertimi se vazhdimi i aktivitetit të punës pas javës së 34-t ka ndikuar në ardhjen e pasojës së vdekjes së fetusit, ndërsa bazuar në dokumentacionin mjekësor është provuar se shtatzënia ka pasur ecuri normale deri në javën e 36-të, prandaj ecuria e shtatzënisë nuk ka pasur ndikim në ardhjen e pasojës. Këto përfundime, pasi i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe janë ballafaquar edhe me fakte e mendime shkencore të paraqitura nga palët në proces, janë vlerësuar si jo të qarta dhe të sakta nga ana shkencore në raport me çështjet e shtruara për ekspertim, ndaj ajo gjykatë ka vendosur kryerjen e një ekspertimi të ri përmes një grupi ekspertësh. Në ekspertimin e dytë është konkluduar se në mungesë të autopsisë shkaku i vërtetë i vdekjes fetale in utero nuk mund të përcaktohej shkencërisht; se mungojnë të dhënat anatomopatologjike për të dhënë një përgjigje përfundimtare të shkakut determinant që ka çuar në fetus morto in utero; se nuk mund të përcaktohej si shkak determinant i vdekjes së fetusit in utero qëndrimi në punë i nënës për atë periudhë që duhej të merrte lejen e paralindjes (mund të jetë faktor rreziku, por jo determinant), dhe se infarktet placentare nuk mund të kenë shkak determinant qëndrimin në punë në periudhën e paralindjes. Referuar këtyre konkluzioneve, gjykata ka çmuar se nuk ka rezultuar e provuar se shkaku i infarktit central që solli pasojën ka qenë qëndrimi në punë dhe vijimi i ushtrimit të detyrës nga paditësja gjatë periudhës 35-ditore të paralindjes. Në këtë prizëm, nuk provohet, sipas saj, se fakti i paligjshëm që paditësja i atribuon punëdhënësit të përbëjë shkakun përcaktues, të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të ardhjes së pasojës, vdekjes së fetusit.

6. Mungesa e paligjshmërisë në veprimet e punëdhënësit kundrejt punëmarrëses gjatë periudhës së punësimit pranë këtij subjekti çon, sipas saj, në konkluzionin logjik se nuk provohet as elementi i *fajit* në veprimet e të padituri, si kriter i domosdoshëm ligjor për përgjegjësinë juridiko-civile me karakter jashtëkontraktor. Pa hyrë në analizën e dëmit të pretenduar nga pala paditëse në drejtim të ekzistencës ose të mungesës së tij, ajo gjykatë ka konkluduar se nuk përmbushen tre prej kushteve thelbësore ligjore për vënien nën përgjegjësi civile të palës së paditur të lidhura me faktin e paligjshëm, fajin në shkaktimin e dëmit dhe lidhjen shkakësore mes veprimit të paligjshëm dhe pasojës së ardhur. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1070, datë 09.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të njëjtin arsyetim si ajo. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit dhe kundërrekurs pala e paditur.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3903, datë 04.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Sipas Gjykatës së Lartë, në

çështjen konkrete nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural me rendësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, ose me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve apo papërdorshmërinë e provave, dhe se vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përkundrazi, ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve e prapësimeve të palëve, sipas provave të paraqitura prej tyre në gjykim. Për pjesën e pretendimeve që ngre çështje të vlerësimit të provave, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj.

9. Në datën 08.06.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

## Pretendimet e kërkuesve

10. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se u janë cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e:

10.1. *Së drejtës së aksesit* e lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka analizuar interpretimin e nenit 104 të Kodit të Punës, nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit mbi karakterin imperativ të normës mbrojtëse, nuk ka trajtuar argumentin mbi barrën juridike të punëdhënësit, nuk ka analizuar standardin kushtetues të mbrojtës së gruas shtatzënë, duke e reduktuar artificialisht çështjen në rivlerësim provash. Pretendimet e kërkuesve nuk kishin të bënin me rivlerësimin e fakteve ose të ekspertizave, por me interpretimin e gabuar të ligjit material, me shpërndarjen antikushtetuese të barrës së mbrojtjes, me neutralizimin e funksionit mbrojtës të nenit 104 të Kodit të Punës dhe moszbatimin e standardit kushtetues te mbrojtjes së shtatzënisë. Arsyetimi i atij vendimi është formal dhe abstrakt, i mbështetur në formula stereotipe dhe nuk jep përgjigje reale ndaj pyetjes themelore juridike "*a mundet një normë imperative e krijuar për mbrojtjen e gruas shtatzënë të interpretohet në mënyrë të tillë që punëdhënësi të mos mbajë asnjë detyrim aktiv për zbatimin e saj?*". Arsyetimi i atij vendimi është edhe kontradiktor, pasi, nga njëra anë, gjykata pranon se punëdhënësi duhet të lejojë punëmarrësen të vijojë punën pas kësaj periudhe, ndërsa menjëherë më pas arsyeton se konstatimi i fillimit të periudhës së

ndalimit të punës nuk është përgjegjësi e punëdhënësit. Nëse punëdhënësi ka detyrimin të mos lejojë vijimin e punës, atëherë ai domosdoshmërisht duhet të ketë edhe detyrimin të verifikojë fillimin e periudhës së ndalimit. Interpretimi i kundërt e bën normën imperativë praktikisht të pazbatueshme.

10.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi përbërja e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë ka ndryshuar, pasi çështja është shpallur për gjykim. Çështja fillimisht është planifikuar për shqyrtim në datën 09.07.2025 dhe është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Çështja është riplanifikuar për në datën 04.11.2025 me përbërje të ndryshuar, ku relatorja V.K. ishte zëvendësuar nga gjyqtari A.K., sipas vendimit nr. 15, datë 10.10.2025 të Këshillit të Gjykatës së Lartë. Ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues në këtë rast është realizuar mbi bazën e një akti administrativ organizativ dhe jo mbi bazën e një procedure individuale gjyqësore të dokumentuar dhe të arsyetuar në dosje, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si dhe sigurinë juridike, transparencën procedurale dhe standardin e gjyqtarit natyral.

10.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat ia kanë transferuar të gjithë barrën në proces gruas shtatzënë, edhe pse kjo bie ndesh me natyrën mbrojtëse të legjislacionit të punës, duke aplikuar një standard disproporcional dhe antikushtetues të barrës juridike. Punëdhënësi ka shkelur haptazi nenit 104 të Kodit të Punës dhe nuk është e drejtë që e gjithë barra e provës për lidhjen shkakësore t'i ngarkohet gruas shtatzënë. Duke vepruar kështu, gjykatat e kanë lënë pa zbatuar kuadrin mbrojtës të nenit 104 të Kodit të Punës, duke cenuar njëherësh edhe nenet 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

10.4. *Së drejtës për një gjykim të drejtë*, për shkak të: i) mosshqyrtimit efektiv të pretendimeve thelbësore të kërkuesve; ii) mosaplikimit të mbrojtjes së shtuar për gruan shtatzënë; iii) mosgarantimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj; iv) mosinterpretimit të legjislacionit të punës në përputhje me funksionin kushtetues të mbrojtjes sociale.

10.5. *Standardit të proporcionalitetit*, që buron nga neni 45 i Kushtetutës, pasi interpretimi i bërë nga gjykatat që punëdhënësi nuk ka asnjë detyrim aktiv për të verifikuar fillimin e periudhës së ndalimit, por e bazon vendimin vetëm në interesin ekonomik të punëdhënësit, duke sakrifikuar plotësisht mbrojtjen kushtetuese të gruas shtatzënë dhe fetusit, pra duke mos mbajtur një ekuilibër të drejtë midis këtyre të drejtave.

10.6. *Mbrojtjes së veçantë të grave shtatzëna*, e garantuar nga neni 54 i Kushtetutës dhe i konkretizuar në nenin 104 të Kodit të Punës. Gjykatat e kanë interpretuar dispozitën në mënyrë të tillë që barra e mbrojtjes t'i transferohej ekskluzivisht gruas shtatzënë dhe punëdhënësi të përjashtohej nga çdo detyrim aktiv, duke bërë që norma mbrojtëse të humbiste efektin praktik. Në rastin konkret, gjykatat nuk e kanë aplikuar këtë standard mbrojtjeje të shtuar, nuk e kanë interpretuar normën në favor të mbrojtjes së shtatzënisë, kanë minimizuar detyrimet aktive të punëdhënësit dhe kanë transformuar normën mbrojtëse në barrë individuale të viktimës. Për pasojë, mbrojtja e garantuar nga neni 54 i Kushtetutës është bërë iluzore.

## III
## Vlerësimi i Kolegjit

*A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës*

11. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ata plotësojnë edhe kriterin e pranueshmërisë lidhur me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së

Lartë, mban datën 04.11.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 25.02.2026, në të cilën palët mund ta dispononin, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 08.06.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në drejtim të kriterit të pranueshmërisë *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në aspektet e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, së drejtës për gjykim të drejtë, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe cenimin e *standardit të proporcionalitetit* dhe *mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna*, që burojnë nga nenet 45 dhe 54 të Kushtetutës.

14. Në kuadër të pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, kërkuesit kanë parashtruar se është ndryshuar përbërja e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë, duke u zëvendësuar gjyqtarja relatore V.K. me gjyqtarin A.K., me anë të një vendimi të Këshillit të Gjykatës së Lartë dhe se kjo përbën shkelje të këtij parimi kushtetues, pasi ndryshimi është realizuar me një akt administrativ organizativ dhe jo me një procedurë individuale gjyqësore të dokumentuar dhe të arsyetuar në dosje. Për rrjedhojë, është cenuar edhe siguria juridike, transparenca procedurale dhe standardi i gjyqtarit natyral, sipas tyre. Fillimisht, Kolegji vëren se me vendimin e referuar të Këshillit të Gjykatës së Lartë (nr. 15, datë 10.10.2025) është ripërcaktuar përbërja e trupi gjykues nr. 2 të Kolegjit Civili të Gjykatës së Lartë për shkak të mungesës së gjyqtares V.K., e cila kishte marrë lejen e lindjes, me qëllim që të mos pengohej veprimtaria gjyqësore e atij kolegji, si dhe të garantohej vijueshmëria normale e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore prej tij. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se kërkuesit, nga pikëpamja kushtetuese, nuk kanë arritur të argumentojnë se cilat kanë qenë pasojat reale dhe të drejtpërdrejta që u kanë ardhur atyre për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues në Gjykatën e Lartë me anë të vendimit të këshillit të gjykatës, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Po kështu, argumenti se është cenuar edhe transparenca procedurale dhe standardi i gjyqtarit natyral për shkak të ndryshimit të përbërjes së trupit gjykues me anë të vendimit të Këshillit të Gjykatës, është haptazi i pabazuar pasi këto vendime janë të publikuara në faqen zyrtare të asaj gjykate dhe në rastin konkret, përcaktojnë edhe arsyen për të cilën është ndryshuar përbërja e trupit gjykues, që është një arsye objektive.

15. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesve, Kolegji vëren se në mbështetje të tyre ata kanë parashtruar se gjykatat e faktit kanë rrëzuar padrejtësisht kërkesën e tyre për dëmshpërblim, si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit nga ana e tyre, dhe se ky gabim nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka shqyrtuar në mënyrë efektive pretendimet

thelbësore të kërkuesve. Për rrjedhojë, këto pretendime do të trajtohen në vijim nga Kolegji në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt *të së drejtës së aksesit* të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

16. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Gjykata ka pohuar se standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykim. Megjithatë, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në jurisprudencë konstante të Gjykatës është pranuar se ato vendime mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 67, datë 03.10.2024; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se në vlerësimin e shkaqeve ligjore të rekursit dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore, nëse kolegji i Gjykatës së Lartë krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore, ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, vendos mospranimin e tij (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata në vijimësi është shprehur se ajo nuk vepron si shkallë e katërt

gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese dhe pretendimeve të kërkuesve, Kolegji vlerëson të analizojë nëse në rastin konkret gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë garantuar të drejtën e kërkuesve për të pasur një përgjigje efektive dhe të arsyetuar për pretendimet e tyre kryesore, si dhe nëse për to ka ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik në arsyetimin e vendimeve të atyre gjykatave, të tillë që do të vinte në dyshim respektimin e së drejtës për një gjykim të drejtë.

20. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me një kërkesë për dëmshpërblim për shkak të vdekjes së foshnjës së tyre, duke thirrur si palë të paditur punëdhënësin e kërkueses së parë. Pretendimi i tyre lidhej me qëndrimin në punë gjatë periudhës së ndalesës ligjore (35 ditë përpara datës së planifikuar të lindjes), që, sipas tyre, ka ndikuar negativisht në shëndetin e nënës dhe fetusit, duke sjellë si pasojë vdekjen e foshnjës gjatë një procesi të parakohshëm lindjeje dhe se është punëdhënësi ai që ka detyrimin për të konstatuar këtë fazë shtatzënie për të mos lejuar punëmarrësin të vijojë procesin e punës.

21. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, pasi ka çmuar se pala paditëse nuk ka arritur të vërtetojë se dëmi i pretenduar, si rrjedhojë e vdekjes së fetusit, ishte pasojë e drejtpërdrejtë, e menjëhershme dhe determinante e veprimeve me faj të palës së paditur të ndërmarra gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës. Ajo gjykatë ka analizuar nëse përmbushen kushtet ligjore për vënien nën përgjegjësi civile për shkaktim dëmi të palës së paditur dhe ka arritur në përfundimin se nuk provohet *veprimi i paligjshëm* i palës së paditur në shkaktimin e dëmit, pasi konstatimi i fillimit të periudhës së ndalimit të punës për gruan shtatzënë nuk është përgjegjësi e punëdhënësit, për shkak se ndonëse shtatzënia është një gjendje fizike drejtpërdrejt e perceptueshme në dukje nga të tretët, evidentimi i fillesës së periudhës së paralindjes përbën një fakt gjinekologjik, i përcaktueshëm vetëm nga personeli mjekësor dhe i materializuar në raportin e paralindjes të lëshuar prej tyre, të cilin punëmarrësi detyrohet t'ia paraqesë punëdhënësit si indicie për shkëputjen e përkohshme të marrëdhënies së punësimit. Në këtë kuadër, ajo gjykatë ka evidentuar se kërkuesja jo vetëm nuk ka arritur të provojë se i ka paraqitur punëdhënësit raportin e paralindjes, por ajo nuk e kërkuar dhe as marrë atë. Në lidhje me elementin e *lidhjes shkakësore* midis sjelljes së paligjshme, fajit dhe pasojës së ardhur, gjykata e shkallës së parë ka lejuar kryerjen

e një ekspertimi mjeko-ligjor, me qëllimin për të përcaktuar shkakun përcaktues dhe të drejtpërdrejtë të vdekjes së fetusit dhe nëse puna e ushtruar nga kërkuesja gjatë periudhës së ndalimit ligjor ka qenë shkaktare. Duke qenë se përfundimin e aktit të ekspertimit ajo gjykatë e çmoi të paqartë, më pas urdhëroi kryerjen e një ekspertimi nga një grup ekspertësh, kësaj radhe gjinekologë, të cilët arritën në përfundimin se në mungesë të autopsisë shkaku i vërtetë i vdekjes nuk mund të përcaktohej shkencërisht, se mungojnë të dhënat anatomopatologjike për të dhënë një përgjigje përfundimtare të shkakut determinant që ka çuar në fetus morto in utero, dhe se nuk mund të përcaktohej si shkak determinant i vdekjes së fetusit in utero qëndrimi në punë i nënës për atë periudhë që duhej të merrte lejen e paralindjes, që mund të jetë faktor rreziku, por jo determinant. Mungesa e paligjshmërisë në veprimet e punëdhënësit çon në konkluzionin logjik, sipas saj, se nuk provohet as elementi i *fajit* në veprimet e të paditurit, si kriter i domosdoshëm ligjor për përgjegjësinë juridiko-civile me karakter jashtëkontraktor (*shih paragrafët 3-6 të vendimit*). Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin arsyetim (*shih paragrafin 7 të vendimit*). Ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, pasi ka vlerësuar se gjykata e apelit ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen, duke u dhënë përgjigje ezauruese pretendimeve e prapësimeve të palëve sipas provave të paraqitura prej tyre në gjykim (*shih paragrafin 8 të vendimit*).

22. Në analizë të vendimeve të kundërshtuara, Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë arsyetuar për pretendimet e kërkuesve të shtruara për diskutim përpara tyre, për përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Në funksion të zgjidhjes së çështjes, ato kanë analizuar nëse përmbushen kushtet ligjore për vënien nën përgjegjësi civile për shkaktim dëmi të palës së paditur, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret kërkuesit, si palë paditëse, nuk kanë arritur të provojnë se dëmi i pretenduar, si rrjedhojë e vdekjes së fetusit, është pasojë e drejtpërdrejtë, e menjëhershme dhe determinante e veprimeve me faj të palës së paditur të ndërmarra gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, në ushtrimin e të drejtave dhe në përmbushjen e detyrave që burojnë nga legjislacioni i punës. Veçanërisht në lidhje me elementin e *lidhjes shkakësore*, gjykatat kanë arsyetuar se mbrojtja e veçantë që i garantohet gruas shtatzënë nga Kodi i Punës është përgjegjësi e të dyja palëve, në të kundërt të pretendimit të kërkuesve se është aplikuar një standard disproporcional i barrës juridike në proces, duke iu transferuar gruas shtatzënë edhe pse kjo bie ndesh me natyrën mbrojtëse të legjislacionit të punës. Megjithatë, ato gjykata kanë çmuar se konstatimi i fillimit të periudhës së ndalimit për të punuar i takon gruas shtatzënë nëpërmjet kryerjes se kontrolleve të specializuara,

të materializuara në raportin e paralindjes. Në këtë kuptim, ato kanë çmuar se kërkuesja nuk është treguar e kujdesshme në vizitat mjekësore dhe përcaktimin e këtyre afateve për t'u drejtuar te punëdhënësi për aplikimin e lejes 35 ditë përpara lindjes së fëmijës. Një përfundim i tillë nuk duket i paarsyeshëm si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe nga fakti i vërtetuar gjatë gjykimit se kërkuesja nuk e ka marrë një raport të tillë te mjeku specialist.

23. Edhe Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të kërkuesve dhe i ka gjetur ato haptazi të pabazuara, pasi ka çmuar se gjykata e apelit e ka zgjedhur drejt çështjen nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit, duke e bërë në këtë mënyrë arsyetimin e asaj gjykate të sajin. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj kushtetues, si gjykatë ligji, u ka dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të kërkuesve, ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit nuk i është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se në vendimet e gjykatave të zakonshme nuk rezulton të ketë ndonjë gabim aq të dukshëm ligjor ose faktik, që një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë dhe që ta bënte gjykimin të padrejtë.

24. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.